

SKEDA E GJYKIMIT Në SHKALLë

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair ZAGANJORI - Kryesues
Evelina QIRJAKO - Anëtar
Andi ÇELIKU - Anëtar

në datën 15.03.2017, në dhomë këshillimi, mori në shqyrtim çështjen administrative me nr. 04237/2014 akti, që u përket palëve:

PADITËS: Shyqyri Dushku
PALË E PADITUR: Instituti i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
OBJEKTI: Detyrimin e palëve të paditura IEVP e DPB të rikthejnë në detyrën e mëparshme paditësin dhe ti paguajnë pagën nga momenti i largimit nga detyra datë 08.05.2008 e deri në rikthimin në detyrë.
BAZA LIGJORE: Nenet 153 e vijues të K.Pr.Civile, neni 7 i Ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensim për burgim të padrejtë”, neni 44 i Kushtetutës së Shqipërisë; neni 3 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 143, 144, 153, 154, 155, 203 të K.Punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 643, datë 23.07.2012, ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit Shyqyri Dushku.
- Detyrimin e palëve të paditura Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë të kthejë në punë paditësin Shyqyri Dushku.
- Detyrimin e palëve të paditura Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë t’i paguajnë paditësit Shyqyri Dushku pagën mujore, nga dita e gjykimit të vendimit penal nr. 1359, datë 07.12.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë deri në rikthim në punë.
- Pushimin e gjykimit për pjesën tjetër.
- Shpezimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 142, datë 14.01.2014, ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Apelit Shkodër për gjykimin e çështjes me nr. Regj. Them. 1307/1835 (00831), datë 02.10.2012 dhe dërgimin e çështjes për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 449, datë 03.03.2014, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. 642, datë 23.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
- Rrëzimin e kërkesëpadisë.
- Shpenzime gjyqësore nuk ka

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 449, datë 03.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me një tjetër trup gjykues.

Tiranë më 15.03.2017

Nr. 31003-04237-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-971 i Vendimit (122)